

Vendim nr. 147 datë 27.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 27.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KIMETE HOXHA**
ALBERT HOXHA

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1043, datë 13.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 00-2024-1043, datë 13.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, deri në shqyrtimin e kësaj kërkesë nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Kimete dhe Albert Hoxha (nënë e bir) janë në një marrëdhënie të posaçme me shtetasit L.Sh., G.Sh. dhe M.Sh. (fëmijët e motrës së kërkueses Kimete Hoxha). Këta shtetas në vitin 1996 jetonin në një apartament banimi të ndodhur në rrugën “Don Bosko”, të regjistruar në emër të shtetasit L.Sh. i cili e kishte vendosur si garanci për kredinë e marrë pranë Bankës Tregtare Agrare, Tiranë. Në vitin 2002 shtetasi L.Sh. ka vendosur t’ia shesë apartamentin kërkuesit Albert Hoxha dhe familjes së tij kundrejt shumës 45 000 USD.

2. Palët nuk kanë nënshkruar kontratë për shitjen e apartamentit dhe në vitin 2003 shtetasi L.Sh. ka ndërruar jetë. Që prej vitit 2002 kërkuesit dhe familjarët e tyre kanë jetuar në këtë apartament, si dhe kanë shlyer edhe pagesën e kështit të fundit të kredisë së marrë nga shtetasi L.Sh. për të liruar këtë pasuri nga barra e kredisë. Kjo pasuri, në datën 04.03.2014, rezulton të jetë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi të paditësve A.Sh. dhe K.Sh. (trashëgimtarët e vetëm të L.Sh.).

3. Në vitin 2014 shtetasit A.Sh. dhe K.Sh. i janë drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt detyrimin e kërkuesve për të liruar dhe dorëzuar apartamentin. Kërkuesit kanë paraqitur kundërpadi me objekt detyrimin e paditësve për kthimin e shumave 45 000 USD dhe 587.146 lekë, si dhe kamatave të arrira të këtyre shumave. Kundërpadia, me vendim të ndërmjetëm të gjykatës, nuk është pranuar të shqyrtohet në këtë gjykim, me arsyetimin se kërkimet e padisë nuk kishin lidhje me ato të kundërpadisë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10236, datë 24.10.2014, ka vendosur pranimin e padisë, duke i njohur paditësit pronarë të vetëm të apartamentit objekt konflikti gjyqësor dhe duke detyruar të paditurit (kërkuesit) të lirojnë dhe t’u dorëzojnë paditësve apartamentin. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit.

5. Gjithashtu, kërkuesit i janë drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt detyrimin e të paditurve, trashëgimtarë të L.Sh., për kthimin e shumave 45 000 USD dhe 587.146 lekë, si dhe kamatëvonesave të arrira të këtyre shumave. Gjykata, me vendimin nr. 3257, datë 21.04.2015, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e trashëgimtarëve të L.Sh. të kthejnë

shumat përkatëse. Vendimi është apeluar nga trashëgimtarët e L.Sh. dhe çështja është ende në proces gjykimi.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1472, datë 16.06.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 10236, datë 24.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke arsyetuar se në gjykim u vërtetua se plotësoheshin kushtet e kërkuara nga neni 296 i Kodit Civil (KC) në lidhje me padinë e rivendikimit të sendit. Ekzekutimi i vendimeve është pezulluar me vendimin nr. 558, datë 11.11.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

7. Mbi bazën e rekursit të kërkuarve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1043, datë 13.03.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

8. Në datën 09.05.2024 kërkuarët i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 20.05.2024.

II

Pretendimet e kërkuarve

9. **Kërkuarët**, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi kërkesa për përjashtimin nga gjykimi në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit A.V. është shqyrtuar nga një gjyqtar që i përket të njëjtit Kolegji të Gjykatës së Lartë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 75 të KPC-së.

9.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës*, të garantuar nga nenet 41 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi Gjykata e Lartë ka disponuar me mospranim të rekursit pa u shprehur në asnjë rresht të vendimmarrjes së saj për mungesën e arsyetimit në vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta në lidhje me vlerësimin e provës me dëshmitarë dhe pretendimet e ngritura në drejtim të së drejtës së pronës. Po kështu, sipas kërkuarve, Gjykata e Lartë nuk është shprehur lidhur me pretendimin për mosrespektimin e ndërgjyqësisë pasive, pasi në gjykim janë thirrur vetëm 2 nga 4 anëtarët e familjes Hoxha, të paraqitur në parashitjet e depozituara pranë saj para

gjykimit të rekursit. Për këtë shkak ajo gjykatë ka cenuar edhe *parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesve

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkesit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

12. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individit përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Në rastin konkret Kolegji vlerëson se kërkesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, ndaj nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë e kanë përmbushur edhe këtë kriter.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vlerëson se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 13.03.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur në datën 09.05.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesit pretendojnë se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën e pronës dhe parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të garantuara nga nenet 41, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

15. Lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, kërkuesit kanë argumentuar se kërkesa për përjashtimin nga gjykimi në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit A.V. është shqyrtuar nga një gjyqtar që i përket të njëjtit kolegji të asaj gjykate, në kundërshtim me parashikimin e nenit 75 të KPC-së.

16. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, konstaton se në datën 29.02.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit A.V. nga gjykimi i çështjes. Kërkesa është shqyrtuar nga gjyqtari S.N., i cili nuk është pjesë e të njëjtit trup gjykues të kolegjit të caktuar për gjykimin e çështjes së kërkuesve. Gjithashtu, nga vendimi i Gjykatës së Lartë rezulton se gjyqtari A.V. është shprehur me mendim pakice për pranimin e rekursit të kërkuesve. Në situatën kur gjyqtari në fjalë ka votuar në favor të kërkuesve, Kolegji çmon se pretendimi i tyre nuk mund të merret në shqyrtim, pasi është haptazi i pabazuar.

17. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, kërkuesi ka parashtruar dy argumente, njëri prej të cilëve lidhet me faktin se Gjykata e Lartë nuk është shprehur për mungesën e arsytimit të gjykatave më të ulëta në lidhje me provën me dëshmitarë dhe pretendimet e ngritura në drejtim të së drejtës së pronës. Ndërsa argumenti tjetër ka të bëjë me faktin që ajo nuk ka arsyetuar për sa i takon pretendimit të tyre për mosrespektimin e ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme. Kolegji, mbështetur në thelbin e argumenteve, çmon se ky pretendim *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetuese, ndaj si i tillë ai do të analizohet në vijim.

18. Konkretisht, kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka disponuar me mospranim të rekursit pa u shprehur në asnjë rresht të vendimmarrjes së saj për mungesën e arsytimit në vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta në lidhje me vlerësimin e provës me dëshmitarë dhe pretendimet e ngritura në drejtim të së drejtës së pronës. Gjithashtu, sipas tyre, ata kanë depozituar parashtrës në Gjykatën e Lartë, të cilat përmbanin shkaqe ligjore për prishjen e vendimit të apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim për mosrespektimin e ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme, për shkak se apartamenti nga momenti i fitimit të pronësisë në vitin 2002 është poseduar nga katër

anëtarë të familjes Hoxha, ndërkohë që si palë e paditur në proces janë thirrur vetëm kërkuesit. Pra, sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë nuk është shprehur në asnjë rresht të vendimit të saj për këtë pretendim.

19. Gjykata ka theksuar se e drejta për një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se vendimet për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen nga Gjykata e Lartë në mënyrë të kufizuar, pasi nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimin të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në çështjen në shqyrtim Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesëpadinë e paditësve, duke i njohur ata si pronarë të vetëm të apartamentit, e duke detyruar kërkuesit të lirojnë dhe t'u dorëzojnë paditësve apartamentin. Kjo vendimmarrje është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar se në gjykim është vërtetuar se plotësoheshin kushtet e kërkuara nga neni 296 i KC-së në lidhje me padinë e rivendikimit të sendit. Gjithashtu, gjykata e apelit në vendimmarrjen e saj ka mbajtur parasyshe edhe faktin e pranuar nga kërkuesit se me vendimin e datës 21.04.2015 gjykata e shkallës së parë ka vendosur detyrimin e trashëgimtarëve të L.Sh. t'u kthejnë kërkuesve shumat 45 000 USD dhe 587.146 lekë të paguara prej tyre për blerjen e pasurisë dhe shlyerjen e këstit të fundit të kredisë. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranim të rekursit të paraqitur nga kërkuesit, duke vlerësuar se gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe atë material, duke i interpretuar dhe zbatuar drejt ato, si dhe vendimi nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

21. Nga ana tjetër, pretendimi për mosrespektimin e ndërgjyqësisë pasive nuk është ngritur nga kërkuesit as në dy gjykatat më të ulëta, as në rekurs, por është paraqitur për herë të parë me

parashtrësën e datës 29.02.2024 drejtuar Gjykatës së Lartë, para marrjes në shqyrtim të çështjes në dhomën e këshillimit.

22. Për sa më lart, Kolegji konstaton se në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuessit, vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsytim të kufizuar, përmban të dhënat e palëve, rrethanat e çështjes, arsyetimin dhe vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, shkaqet e rekursit, si dhe pjesën arsyetuese ku gjykata ka mbështetur qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Ajo gjykatë, pasi ka analizuar dhe vlerësuar vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta në raport me shkaqet e paraqitura në rekurs, faktet e çështjes dhe ligjin e zbatueshëm, në përfundim ka vlerësuar se nuk ka shkaqe ligjore për ndryshimin e tyre. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ajo ka plotësuar mjaftueshëm standardet kushtetuese të arsytimit të vendimit gjyqësor, ndaj dhe pretendimi i kërkuessve për cenimin e këtyre standardeve është haptazi i pabazuar.

23. Për sa i takon kërkimin për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 00-2024-1043, datë 13.03.2024 të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se neni 45, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se ai vendoset nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose nga Gjykata në seancë plenare, pra kur vlerësohet se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë. Në kushtet kur ankimi kushtetues konkret nuk i plotëson kriteret paraprake, atëherë Kolegji vlerëson se kërkitimi për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.